



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
INSTITUTI I SHËNDETIT PUBLIK
TIRANË

Rruga: “Aleksandër Moisiu”, Nr 80, Tiranë, Albania.
Tel: +355 4374756, Fax 355 43 70058

Tiranë, 6 /08/ 2009


BULETINI EPIDEMIOLOGJIK MBI QARKULLIMIN DHE PASOJAT NE
SHENDET TE GRIPIT TE RI PANDEMIK A(H1N1) NE SHQIPERI

6 Gusht 2009

Me poshte jepet nje pershkrim i gjendjes epidemiologjike dhe pasojave shendetesore lidhur me Gripin e ri pandemik A(H1N1)ne Shqiperi deri ne daten 5 Gusht, 2009.

A. Prirja e Infeksioneve Respiratore Akute

Fig.A.1. Frekuenca e hasjes së “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme” në javët 20 -31 të sezonit 2007 - 2008 dhe të sezonit 2008 - 2009. Numri i rasteve.



Ne grafikun e mesiperm duket qarte qe aktualisht kemi nje aktivitet normal te infeksioneve respiratore te ngjashem me nje vit me pare. Pamvaresiht numrit disi me te larte te vene re kete vit duhet te theksojme se kemi nje rritje te numrit te qendrave qe raportojne.

Fig.A.2. Frekuenca e hasjes së Infeksioneve Respiratore (të Sipërme dhe të Poshtëme) sipas rretheve në javën e 30-të dhe javën e 31-të të vitit 2009. Incidenca (raste/10.0)






Fig.A.3. Shpërndarja e “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme” sipas grup moshave. Numri absolut i rasteve dhe incidencia: raste/10.000



Nga grafiku i mesiperm duket qarte se kemi nje numer me te madh rastesh ne moshat feminare dhe me tej nje rritje te lehte ne moshat mbi 45vjec.

Fig.A.4. Krahasimi i aktivitetit të “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme” sipas sezoneve (javët 40 – 31) dhe Pragu Epidemik. Raste/100.000



Nga grafiku i mesiperm vihet re qe nuk kemi shperthim epidemik te infeksioneve respiratore apo semundjeve te ngjahme me Gripin. Por duhet te theksojme se edhe ne vendet ku ka patur shperthime epidemike si edhe nje numer te madh rastesh nga Gripi Pandemik A(H1N1) nuk vihet re kapercimi i pragut epidemik.

B. Survejanca Virologjike

Fig.B.1. Numri i mostrave te mbledhura deri me daten 5 Gusht 2009. N = 320




Fig.B.2. Numri i mostrave te mbledhura dhe shpërndarja e rasteve të konfirmuara dhe të mundshme te Gripit A(H1N1) sipas dates së raportimit.







Fig.B.3. Shpërndarja e rasteve prej te cileve jane marre mostra perfshi ketu edhe rastet e konfirmuara dhe te mundshme sipas grupmoshes.



* Ne tre grafiket e mesiperm:

 Me ngjyre te kuqe jane paraqitur rastet e konfirmuara me Gripin Pandemik A(H1N1)

 Me ngjyre roze jane paraqitur rastet e mundshme me Gripin Pandemik A(H1N1)

Numri me i madh i mostrave eshte marre ne grupmoshen 25 - 44 vjeç

Fig.B.4. Numri i rasteve të raportuara sipas diteve dhe shperndarja kumulative e mostrave të mbledhura.






Fig.B.5. Peshë specifike e IRA / SRRA ndaj totalit të rasteve që është marrë moster



Nga grafiku B.5. vihet re qe nuk kemi nje numer te larte IRA/SRRA dhe gjithashtu asnje rast te mundshem apo te konfirmuar midis tyre.

C. Kurba Epidemike

Fig.C.1. Shperndarja e rasteve te konfirmuara dhe te mundshme te Gripit A(H1N1) sipas dates se fillimit te semundjes, deri me daten 5 Gusht.



D. Shpjegim per rastet e konfirmuara dhe te mundshme

- **Raste te konfirmuara** jane te gjitha rastet te cilat kane plotesuar perkufizimin e rastit dhe jane konfirmuar te infektuar me virusin e gripit pandemik A(H1N1) ne laboratorin e references per Europen JugLindore ne Bukuresht, Rumani
- **Raste te mundshme** jane te gjitha rastet te cilat kane plotesuar perkufizimin e rastit dhe jane konfirmuar te infektuar me virusin e gripit A ne laboratorin e Virologjise prane ISHP, Tirane
- **Raste te dyshimta** jane te gjitha rastet plotesojne perkufizimin e rastit.

D.1. Historia e udhëtimit

Per 8 rastet e konfirmuara :

3 prej rasteve janë marinarë të huaj të moshës 30, 31 dhe 41 vjeç (Spitali Rajonal - Durrës) të cilët tashmë janë larguar nga vendi.

4 raste jane te lidhura me udhetimin kryesisht Mbreteria e Bashkuar

Për 1 rast nuk eshte raportuar lidhje epidemiologjike qe te faktoje rrugen e infektimit.

Rastet jane kryesisht ne **Tirane** dhe vetem 1 rast ne **Lushnje**.

Per 13 rastet e mundshme:

Nga keto raste:

- **4 prej tyre** jane paraqitur me shenja te semundjes menjehere pas **kthimit nga jashte vendit** (Mbreteri e Bashkuar).
- **8 raste nuk referojne udhetime** jashte vendit apo lidhje epidemiologjike qe te faktoje rrugen e infektimit.
- 1 rast ka qene kontakt i nje rasti te dyshuar
- 3 raste jane identifikuar jashte Tiranes: **Vlore(2) dhe Sarande (1)**

D.2.Paraqitja klinike

Te gjitha rastet paraqiten kuader klinik te lehte. Shenjat e shfaqura ishin temp > 38⁰ C, dhimbje koke, dhimbje fyti, kolle, dhimbje muskulare dhe lodhje. Vetem **dy raste** te mundshme paraqisnin shenja klinike per te cilin u gjykua **shtrimi ne spital dhe vetem per 5 raste** u fillua trajtimi me **Tamiflu**.

Te gjitha rastet e tjera nuk kane patur komplikacione dhe nuk jane shtruar ne spital. Izolimi i tyre eshte kryer ne kushtet e shtepise. **2 raste** jane trajtuar ne kushte **ambulatore dhe nden mbikqyrjen e mjekut me Tamiflu**.

D.3. Grup moshat.

Per 8 rastet e konfirmuara 4 raste jane te grup moshave **15-24 vjeç**, dhe **4 te tjere 25 - 44 vjeç**.

11 rastet e mundshme jane te grup moshave 16 - 61 vjec, ku predominon mosha nga 25 – 44 vjeç.

Nuk ka asnje rast te moshave pediatrike.

D.4. Semundje shoqeruese.

Asnje nga rastet nuk paraqiste semundje shoqeruese perfshi ketu semundje respiratore obstruktive, semundje kronike te zemres, diabet, semundje qe demton imunitetin apo shtatezani.

D.5. Insuficienc Respiratore Akute (IRA)/ Semundje e Rende Respiratore Akute (SRRA)

Ne sistemin e Survejances se Dedikuar Spitalore perfshihen edhe 2 sindromat e meposhteme:

- Insuficienc Respiratore Akute(IRA)/ Semundje e Rende Respiratore Akute (SRRA)
- Semundje e rende e pashpjeguar dhe vdekje e papritur

Qe nga data 20 Qershor jane identifikuar **6 raste** te te shtruara ne spital te raportuara nga Spitali rajonal Shkoder (2), Spitali rajonal Elbasan (2), Spitali rajonal Gjirokaster (1) dhe Spitali Pediatrik, QSUT (1). Rastet kane qene te grup moshave 48-63 vjec (3 raste) , 1 vjec (2 raste) dhe nden 12 muaj (1 rast). Te gjitha rastet kane rezultuar negative per virusin e Gripit Pandemik A(H1N1).

Deri tani nuk eshte raportuar asnje vdekje.

D.6. Marrja e mostrave dhe analizimi i tyre

Cdo dite ne ISHP perpunohen mostra te rasteve te dyshuara nga Tirana dhe rrethet e tjera te vendit. Laboratori i virologjise ne ISHP eshte pjese e rrjetit europian te survejances se gripit dhe raporton cdo jave prane ketij rrjeti.

Aktualisht ne kete laborator po analizohen mesatarisht mbi 30 mostra cdo jave. Ne kete laborator kryhet testi i Imunofluoreshences Direkte dhe testi i shpejte qe japin pergjigjen paraprake te identifikimit te virusit brenda 2 oresh. Me pas kryhet kultura ne linja qelizore nga ku izolohet virusi dhe kjo procedure zgjat nga 24-72 ore. Si pasoje e rikonstruksionit te laboratorit te virologjise konfirmimi per nentipin kryhet prane laboratorit te references per Europen JugLindore ne Bukuresht, Rumani ku dergohen mostrat e mundshme por edhe te dyshuara.

Te gjitha rastet e mundshme te identifikuara me Virusin e Gripit A do te trajtohen njesoj si A(H1N1) nga pikpamja e ndjekjes dhe kontrollit.

